



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 08.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 07.01.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.P.N EUROING SH.P.K** nga Rahoveci, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Ndërtimi i QKMF në Shtime**”, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **N.P.N EUROING SH.P.K** e datës 07.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ndërtimi i QKMF në Shtime**”, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 19.12.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë, i datës 19.12.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **N.P.N EUROING SH.P.K** ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i QKMF në Shtime**”, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**,. Autoriteti Kontraktues, me datë 08.01.2025, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-se-Qellimi

Neni 7 i LPP-se-Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 i LPP-se-Specifikimet teknike

RREGULLORE Nr.001/2022 PER PROKURIMIN PUBLIK NENIN 63

Pretendimet ankimore - Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet sipas OE ankues:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit për ndërtimin e Qendrës së Kujdesit për Maternitet dhe Familje (QKMF) në Shtime, dhe më konkretisht të kushteve të përfshira në kriteret e pjesëmarrjes, dëshirojmë të paraqesim kërkesën tonë për rishqyrtimin e një kriteri të caktuar, në lidhje me natyrën e punëve të pranueshme dhe përvojën e kërkuar për operatorët ekonomikë.

Kriteri aktual kërkon që operatorët ekonomikë të kenë referenca nga punë të kryera në ndërtimin e objekteve shëndetësore, si spitale ose QKMF. Ne konsiderojmë se ky kriter është tepër i ngushtë dhe nuk pasqyron plotësisht aftësitë dhe përvojën e operatorëve ekonomikë që mund të kontribuojnë në realizimin e këtij projekti. Për këtë arsye, kërkojmë që të rishqyrtohet mundësia e pranimit të referencave për ndërtimin e objekteve të tjera shëndetësore si si dhe objekte sociale dhe institucionale, si shkolla dhe çerdhe, Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF), që përfshijnë elemente të njëjta ndërtimore dhe teknika inxhinierike.

Arsyetimi për Kërkesën:

1. Ngjashmëritë në Proceset e Ndërtimit: Ndërtimi i një objekti shëndetësor (spital, QKMF) dhe ndërtimi i objekteve të tjera shëndetësore dhe institucionale, si Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF), shkolla, çerdhe, përfshin të njëjtat procese dhe teknika ndërtimore. Puna e përfshirë në këto projekte përfshin gërmimin, zhavorin, betonin, armaturën, muraturën, suvatimin, instalimin e sistemeve të kanalizimeve dhe ujit, kulm, dritare, oborr etj., si dhe punë të tjera inxhinierike që janë të ngjashme në të dyja rastet. Kështu, çdo operator që ka përfunduar projekte të tilla ka përvojë të nevojshme për të realizuar punët ndërtimore për një objekt shëndetësor, pa pasur nevojë për eksperiencë të veçantë në ndërtimin e spitaleve ose QKMF-ve.

2. Arsyetim dhe argument mbi ngjashmerite e procesit të ndërtimit: Ky tender është specifik për ndërtimin e QKMF-së dhe, përveç disa kushteve specifike për hapësirat e brendshme dhe organizimin e ambienteve, nuk kërkohet furnizimi ose instalimi i pajisjeve shëndetësore, teknologjisë mjekësore, ose elementeve të tjerë të specializuar për shëndetësinë.

Kjo e bën të paarsyeshme kërkesën për përvojë specifike në ndërtimin e spitaleve, pasi operatorët ekonomikë që kanë realizuar projekte të tjera shëndetësore, si AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare), janë po aq të aftë dhe të kualifikuar për të realizuar ndërtimin e QKMF-së, që konsiston kryesisht në procese ndërtimi dhe jo furnizim me pajisje mjekësore.

3. Përvoja e Operatorëve Ekonomikë në Ndërtim: Ndërkohë që ndërtimi i një objekti shëndetësor mund të përfshijë elemente specifike si dhoma të veçanta për shëndetësi, ky tender nuk ka përfshirë asnjë kërkesë për pajisje shëndetësore ose sisteme të veçanta që kërkojnë njohuri dhe aftësi të thelluara në teknologjinë shëndetësore. Përkundrazi, operatorët ekonomikë që kanë ndërtuar objekte si shkolla, çerdhe, AMF ose ndërtesa të tjera sociale kanë të njëjtën përvojë ndërtimore dhe janë po aq të aftë për të realizuar këtë projekt.

Aspekti Ligjor dhe Parimet e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës

Përveç argumenteve inxhinierike dhe teknike, është e rëndësishme të theksojmë që kërkesa për përvojë specifike në ndërtimin e objekteve shëndetësore, si spitale dhe QKMF, mund të shkelë disa nga parimet e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, në veçanti ato që lidhen me barazinë, transparencën dhe konkurrencën e hapur.

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe me aktet nënligjore të lidhura, përfshirë Ligjin Nr. 06/L-087 për Prokurimin Publik, kërkesa për përvojë të veçantë në ndërtimin e objekteve shëndetësore mund të konsiderohet si diskriminim dhe favorizim të operatorëve ekonomikë të caktuar, duke kufizuar mundësinë e pjesëmarrjes të operatorëve të tjerë që kanë përvojë të ngjashme, por jo specifikiht në ndërtimin e spitaleve.

- Neni 7 (Parimet e Prokurimit) të Ligjit për Prokurimin Publik thekson që çdo procedurë prokurimi duhet të sigurojë barazi të trajtimit, transparencë dhe konkurrencë të hapur. Caktimi i kritereve të tilla që favorizojnë një kategori të veçantë operatorësh ekonomikë është në kundërshtim me këto parime.

- Neni 68 (Ndalohet Diskriminimi) thekson se diskriminimi i operatorëve ekonomikë për arsye të natyrës së punëve të kryera apo përvoja të caktuara që nuk janë të drejtpërdrejta lidhur me natyrën e projektit është i ndaluar dhe nuk duhet të ndikojë në mundësinë e konkurrencës së lirë dhe të barabartë.

Në këtë kontekst, kërkojmë që të rishqyrtohet dhe ndryshohet kriteri i referencave të punëve të kryera, duke përfshirë ndërtimin e objekteve shëndetësore të ngjashme si Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF), si dhe objekte sociale dhe institucionale, të tilla si shkolla, çerdhe dhe objekte të ngjashme, si referenca të pranueshme për operatorët ekonomikë. Ky ndryshim do të mundësojë një konkurrencë më të drejtë dhe më të hapur, duke i dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë që kanë përvojë të gjerë në ndërtim të marrin pjesë në këtë tender, pa pasur kufizime të panevojshme që lidhen me natyrën specifike të objektit shëndetësor.

Ky amendament nuk do të ndikojë në cilësinë e punës dhe do të sigurojë realizimin e projektit në përputhje me standardet më të larta të ndërtimit, pa pasur nevojë për specializim të veçantë në pajisje shëndetësore.

Faleminderit për shqyrtimin e kërkesës sonë. Shpresojmë që kjo kërkesë do të pranohet dhe mbetemi të gatshëm për çdo informacion shtesë që mund të jetë i nevojshëm.

Gjithashtu kërkohet që të korrigohet Dosja e Tenderit (formulari B54) dhe shtyhet afati për dorëzimin e tenderëve.

**Neni 7 i LPP: Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi
Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkohet nga AK që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE N.P.N EUROING SH.P.K

Korrigohet Dosja e Tenderit (formulari B54) dhe shtyhet afati për dorëzimin e tenderëve.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Të konsiderueshme.

Pergjigjja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Kerkesa juaj per rishqyrtim eshte trajtuar nga ana e AK-MSh, dhe konsiderojme se pretendimi juaj ankimor eshte i pa bazuar, andaj mbetet ne fuqi kriteri sipas NJK dhe Dosjes se Tenderit.


AK-MSh konsideron se ky kriter nuk eshte diskriminues dhe ne vazhdimësi eshte përdorur te aktivitetet e ngjashme, me ç' rast ka pasur konkurrencë mjaft te gjere.

Pretendimi juaj do te ishte e drejte sikur kriteri te kishte kufizuar vetëm NDERTIMIN por ne këtë rast kërkesa e AK eshte **ndërtim ose renovim** dhe mjaft kompani kane bere ndërtime e sidomos renovime te objekteve te tilla QKMF apo të niveleve më të larta të shëndetësisë, ku përfshihen ndërtime/renovime te QKMF-ve, Reparteve Spitalore, Klinikave, publike apo private, etj

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit